



Zef Mazi: Shqipëria nuk ka pse pret zgjidhjen e konfliktit Sofje-Shkup për të hyrë në Evropë

1. Zoti Mazi, edhe një herë më tepër negociatat e Shqipërisë me Bashkimin Evropian u shtynë për Samitin e rradhës. Cilat janë konkluzionet që nxirrni nga takimi i fundit në Bruksel?

Përgjigje: Po bëj një sqarim, një saktësim, sepse vërej përsëritje pasaktësie. Negociatat politike me Shqipërinë janë hapur me vendimin e Samitit të Zagreb-it në mars 2020. Shtyrjet është një fjalë që përdoret për uljen në tryezë, për negociata teknike. Ky është vetëm hapi i parë, fillimi i procesit të negociatave. Nga kjo pikë ato do zgjasin për një numër vitesh. Shtyrjet tashmë po bëhen të zakonshme. U mësuam me to. Ato nuk habisin më.

Këshilli Evropian mbledhet si rregull katër herë në vit. *Presidenca e radhës mund të vendosë të thërrasë mbledhje shtesë të Këshillit, sipas urgjencës të çështjes. Vendimin për uljen në tryeze për fillimin e negociatave teknike, përmes konferencës të parë ndërqeveritare, e merr Këshilli.* Përgatitjen e punës për Këshillin e kryen COREPER – që është Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm i ambasadorëve), sipas artikullit 16(7) të Traktatit të BE-së dhe artikullit 240(1) të Traktatit për Funkcionimin e BE-së.

Sikur po zgjatëm pak, por duhet të kuptohet mirë procedura, nga publiku.

Konkluzionet e këtij procesi kanë prodhuar deri më sot kombinim të keqardhjes, mërzisë jo të vogël dhe me të drejtë, me realitetin, me pafuqinë e BE-së. Ky është Unioni Evropian, këtu duam të hyjmë, vetëm ky është objektivi, dhe do të hyjmë. Duhet durim dhe përsëri durim. Të tilla janë labirintet e korridoreve të tij, i interesave të shteteve anëtare.

2. Tashmë është bërë e modës të konsiderohet qëndrimi bullgar si shkaktari i mbajtjes pezull të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në këtë proces. Si e shihni insistimin evropian për mosndajren e dy vendeve në fjalë, në raport me hapjen e negociatave?

Përgjigje: Dinamikat e përpjekjeve dhe deri diku edhe rezultatet e tyre, sado të pjesëshme, të vogla, janë tepër intensive. Edhe ndjekësit nga afër, apo ata që janë brenda, e kanë të vështirë të thonë është kështu ose ashtu. Duket kemi të bëjme me kombinim qëndrimesh. Ai bullgar është ai që është, dihet. Miratimi i propozimit francez nga parlamenti bullgar, mjaft i mirepritur, por nuk erdhi pa kushte. A është presion ndaj Maqedonisë së Veriut? Të shohim si do ecet më tej. A është Maqedonia e Veriut e gatshme të plotësojë kushtet që i kërkohen? Edhe kjo mbetet të shihet. A do ishte dakord të bëhën rregullime kushtetuese, dhe për cilën pikë specifikisht? Deri ku mund të shkohet në këtë drejtim? Sa kohë do duheshin për të bërë rregullime kushtetuese, nese do kishte dakordësi për këtë etj., etj.

A po kuptohet nga vendet anëtare të BE-së se të gjithë argumentat për të mbajtur bashkë Shqipërinë dhe Maqedonië e Veriut po shterojnë? Unë mësoj se po kuptohet gjithnjë e më shumë. Sa arrij të kuptoj, jemi mjaft afër një konsensusi ndër vendet anëtare për të diskutuar dhe vendosur se tashmë rruga e vetme është ndarja e dy vendeve.

Kjo do të ishte zbatimi konkret i mantrës së zgjerimit të BE-së: **zgjerimi bazohet vetëm tek merita individuale (e kandidatit)**. Jo tjetër. Mbajtja bashke e dy ose më shumë kandidatëve nuk figuron në asnjë vendim, rezolutë, direktivë apo tjetër dokument zyrtar të Këshilit. Hyrja e kandidatëve në BE sanksionohet qartësisht në Artikulin 49 të Traktatit të BE-së. Gjithcka tjetër është sikur të bësh akrobaci. Ato elementë që mbeten të futen na ekuacionin e mos-ndarjes janë “interesi gjeostrategjik, ekonomik, mbulimi i pafuqisë dhe mos-interesi, mungesa e oreksit për zgjerim”!

3. Kryeministri Rama pati tone të ashpra gjatë dhe pas Samitit. Çfarë impakti ka një qëndrim i tillë në lidhje me perspektivën e hapjes së negociatave?

Përgjigje: Kryeministri Rama përdori vende-vende tone disi të ashpra. Për këtë nuk duhet patur dhe as duhet të krijohen keqkuptime, me ose pa qëllim. “Tonet”, si i karakterizoni ju, unë i shoh si shprehje të mërzisë të thellë, të nevojës për ta dëgjuar dhe mësuar të gjithë sesa të zhgënjyer jemi ne, i gjithë vendi ynë, përmes qëndrimit të Kryeministrit, për këtë pafuqi të ndjeshme, të prekshme, të përsëritur, deri ofenduese, të BE-së ndaj Shqipërisë.

Thjeshtë, qëndrimi i Edi Ramës ishte një thirrje për BE-në: bëni atë që duhet të bëni, mbani premtimet, vendi ynë kandidat i ka plotësuar gjithë kushtet dhe kërkesat tuaja për t’u ulur në tryezën e bisedimeve, në Konferencën e parë ndërqeveritare. Boll me sajesa! Pati një numër kryetarësh të qeverive që e përgëzuan për fjalët direkte, logjike, edhe pse herë-herë pati edhe diçka më emotive. Në lidhje me zgjerimin, vendimin për uljen në Konferencën e Parë Ndërqeveritare, të asaj që ne prisnim prej tashmë dy vitësh, ky Këshill shënoi një dështim të suksesshëm.

Them se asgjë nuk do të ndikojë në perspektivën e hapjes të negociatave teknike përveç mosvullnetit politik të Këshilit, ose disave në Këshill, për mosmarrjen e vendimit të duhur. Janë të tjerë elementë, i përmendëm më lart, që janë të lexueshëm që e mbajnë ende pezull vendimin e duhur. Por ne kemi durim, do kemi durim. Sot ndoshta jo më me emocionet e mëparshme.

4. Cila është prognoza juaj sa i përket javëve dhe muajve në vijim? Kur prisni të marret një lajm i mirë nga Brukseli në lidhje me procesin në fjalë?

Përgjigje: E kam të vështirë të them se kur do të ndodhë kjo që thoni. Ndoshta në mbledhjen e parë të GAC (Këshilli i Cështjeve të Përgjithëshme në korrik) zgjerimi (lexo: Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut) do jetë në rendin e ditës në GAC. Di që Presidenca çeke do e ketë prioritet kryesor zgjerimin. Muaji gusht është pushim. Rifillimi i bie të jetë në shtator. E thashë më lart, Presidenca ka të drejtë të thërrasë mbledhje shtesë të Këshillit nëse urgjenca e çështjes e kërkon.

Mendoj se do ketë diskutime dhe konsultime intensive për zgjidhjen e ngërçit Maqedoni e Veriut-Bullgari. Paralel shikoj se do ketë zhvillime edhe lidhur me ndarjen e dy shteteve kandidatë. Sot ende nuk ka konsensus për këtë në BE. Interesi i vendit tonë është që për këtë çështje të ketë konsensus në BE. Prandaj nuk duhet të kemi ngutje, edhe pse një farë padurimi vihet re në mbarë opinionin tonë popullor, politik, akademik, mediatik etj.

5. Çfarë mendimi keni për propozimin francez për krijimin e një komuniteti politik evropian? A i bashkoheni skeptikëve të cilët thonë se po krijohet një tryezë që do të mbajë larg procesin të integritetit vende që tashmë janë në rrugën e afrimit me BE?

Përgjigje: Propozimi francez që unë kam parë është në një faqe format A4. Është një ide e re, ose më saktë e vjetër, në formë të re. Idetë e reja janë të mira, ato i shërbejnë diskutimit, analizës, shkëmbimit të mendimeve për aspektet e ndryshme të propozimit. Si i tillë propozimi është i vlefshëm. Ai mund të ofrojë një platformë për diskutime të mëtejshme. Unë kam dijeni se ai është diskutuar deri tani vetëm në një seance konsultimi në Bruksel.

Kuptohet se nuk mund të merrej vendim për këtë propozim me një diskutim. Hamendësoj se do ketë diskutime të tjera që do i trajtojnë tërë elementet. Ne do të presim rezultatet dhe konkluzionet formale të diskutimeve brenda BE-së.

Ideja e një konfederatë ka qenë propozuar disa herë. Ideja e “Shteteve të Bashkuara të Evropës”, për herë të parë, është hedhur nga një shkrimtar i famshëm francez që u muar edhe me politikë, Viktor Hygo, nga mesi i shekullit 19-të. Për konfederatë u fol edhe gjatë luftës të dytë botërore. Për herë të fundit u hodh si propozim nga ish Presidenti francez, Mitterrand. Ideja nuk pati sukses. Sot BE-ia ka edhe elementë të një supra-shteti dhe elementë ndërqeveritarë. Si e tillë nuk mund të karakterizohet as si njëra, as si tjetra.

Propozimi i ri, shpjegimi i saj, thotë se projekti francez nuk ”zëvendëson zgjerimin e BE”. Unë them se nuk duhet të jetë as “komplementar për zgjerimin”. Është e udhës të jetë e qartë idea në fjalë, përfshirë shprehimisht në ecurinë e diskutimeve për të, si një proces që nuk ndikon në

proceset integruese që kanë nisur dhe janë duke ecur (prej vitesh). Hapat për zgjerim janë të qartë dhe të përcaktuar me kohë, që me kriteret e Kopenhagenit. Ecuria e metejshme duhet të sigurojë që “njeri nga stacionet e rrugës” të “mos kthehet në stacionin fundor”.

6. Cfarë prisni nga Presidenca çeke e BE-së?

Përgjigje: I uroj suksese qeverisë çeke në marrjen e Presidencës të radhës të BE-së më 1 korrik 2022. Pres që prioriteti i zgjerimit të Unionit të materializohet me marrjen e vendimeve përkatëse, që në korrik, ose maksimumi në shtator. Pres miratimin e kornizës negociuese dhe pozicionin e përgjithshëm të BE-se për Shqipërinë, si dhe datën për Konferencën e parë Ndërqeveritare.

Pres gjithashtu që, nëse deri në fund të qershorit nuk do ketë përparim në zgjidhjen e ngërçit midis dy fqinjëve dhe miqve të mirë e të ngushtë, në korrik, maksimumi në shtator, të ecet me hapin e nevojshëm të radhës, tashmë domosdoshmëri. Nuk ka as edhe një arsye që të mbahen lidhur dy shtete kur Shqipëria nuk ka as edhe një lidhje me mosmarrëveshjen bullgaro-maqedone. Shqipëria është tek dera e BE-së krejtësisht “genuinely”, autentike, e vërtetë, pa asnjë bagazh, në asnjë aspekt. Ajo ka vetëm rezultate. Nuk mjafton që ato të njihen dhe vleresohen. BE-ia të veprojë, të mbaje premtimet, të ulemi në tryezë, të ruajë dhe të rrisë kredibilitetin e saj, me vepra.

Intervistoi: Skënder Minxhozi

Kjo interviste është pjese e serise se shkrimeve “Media dhe Integrimi European”, te Institutit Shqiptar te Medias, ne kuadrin e Programit te Promovimit te Tranzicionit te Republikes Ceke.